



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:071415

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05680980

C.nr.799/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN– **Departamenti i përgjithshëm– Divizioni civil**, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Avokatëve “Arbresh”, me seli në Prishtinë e të cilën e përfaqësojnë av. A.P. dhe M.D. nga Prishtina, kundër të paditurit G.J. me numër personal me vendbanim në rrugën “.....”, në Prizren, me objekt të padisë rimbursim i dëmi, vlera e kontestit 725.00 €, në seancën e mbajtur të shqyrtimit gjyqësor, me datën 14.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET** se është tërhequr padia me numër C.nr.799/20, e paditëses Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit G.J. nga Prizreni për çështjen juridike me objekt kontesti rimbursimi i dëmit.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në Prishtinë, ka ushtruar padi në këtë Gjykatë me datë 18.06.2020, kundër të paditurit G.J. nga Prizreni me objekt të padisë rimbursim i dëmi, vlera e kontestit 725.00 €.

Pas mbajtës së seancës përgatitore me datë 11.04.2024, në të cilën ka marrë pjesë i autorizuarit i paditëses, e në mungesë të të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesore me datë 14.05.2024, në të cilën nuk ka prezantuar i autorizuari i paditëses as i paditurit, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregull, ndërsa që mungesën e tyre në seancë nuk e kanë arsyetuar.

Në bazë të nenit 423 par.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), parashihet se “*Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit*”. Andaj bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata padinë e paditëses në këtë çështje kontestimore e konsideroj të tërhequr.

Numri i lëndës: 2020:071415

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05680980

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 423 par.3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:071415, 14.05.2024

G j y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.